

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE**

Përgjegjës i Sektorit të Statistikave, Drejtoria e Analizës dhe Standardeve, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në zbatim të nenit 26, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të VKM nr.242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

1 (një) Përgjegjës i Sektorit të Statistikave, Drejtoria e Analizës dhe Standardeve, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - Kategoria: III-a (e barazvlefshme me klasën III-1¹).

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

05/11/2023

LËVIZJE PARALELE

Afati për dorëzimin e dokumentave për:

12/11/2023

NGRITJE NË DETYRË

¹ Referuar kreut IV, pika 4, të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike.”

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Ndjek punën me qëllim përgatitjen e udhëzimeve dhe metodologjisë përkatëse që lidhen me kërkime dhe analiza statistikore në kuadër të përmirësimit të raportimeve dhe analizave periodike;
- Jep kontributin e tij në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të aktivitete studimore dhe kërkimore në kuadër të përmirësimit të proceseve analizuese dhe raportuese të lidhura me veprimtarinë dhe angazhimet e institucionit;
- Ndjek punën për analizën e finformacionit në lidhje me historikun e vendimeve për çështje të ngjashme nga gjykatat dhe zyrat e prokurorive që kanë lidhje me kompetencat e ILD-së;
- Mbikqyr punën në grumbullimin e informacionit dhe përgatitja e analizave të nevojshme statistikore mbi veprimtarinë e ILD;
- Mbikqyr procesin e punës në përgatitjen e raporteve dhe analizave statistikore me qëllim rritjen e transparencës së punës së ILD;
- Jep kontributin e tij në hartimin dhe përditësimin e formularëve tip statistikor, që do të përdoren me qëllim grumbullimin, përpunimin dhe analizën e informacionit të nevojshëm lidhur me veprimtarinë e ILD-së;
- Koordinon dhe ndjek punën për hartimin e raporteve dhe përgatitjen e analizave në lidhje me veprimtarinë e institucionit si dhe të angazhimeve të ndërmarra në ushtrim të funksioneve nga ILD;
- Koordinon procesin e punës për ndërtimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave të ankesave të mbartura nga KLD por edhe të ankesave të reja të adresuara në ILD;
- Koordinon punën për përgatitjen e raporteve/analizave me baza mujore, 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore në lidhje me trajtimin e ankesave, hetimit të shkeljeve disiplinore si dhe fillimin e procedurave disiplinore të paraqitura nga persona fizikë, persona juridik apo institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë;
- Koordinon punën për përgatitjen e raporteve/analizave për të gjitha projektvendimet e miratuara nga ILD, projekt vendimet e kthyer si dhe projektvendimet e ndryshuara nga ILD;
- Jep kontribut dhe ndjek procesin e punës për Përgatitjen e Vjetarit Statistikor të ILD (shqip dhe anglisht) dhe menaxhon procesin e shpërndarjes së tij në institucionet e drejtësisë me të cilat bashkëpunon;
- Grumbullon, përpunon dhe përditëson të dhënat statistikore që lidhen me proceset e inspektimit nga përfaqësuesit e njëjësive përkatëse (njësia e inspektimit dhe nga ndihmësinsektorët).

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori III-a ose III-a/1 (e barazvlefshme me klasën III-1/III-2²);
- b) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c) Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike/ Shkenca Natyrore, Dega Matematik. *Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.*
- b) Të kenë jo më pak se 3 vjet përvojë pune në profesion.
- c) Preferohet të ketë të paktën 1 vit përvojë pune në fushën e statistikave.
- d) Të zotërojnë gjuhën angleze.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
- d) Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- h) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore, në linkun: <https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- i) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (për kandidatët në marrëdhënie pune 6 mujori i parë i vitit 2023);
- j) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- k) Dokument që vërteton zotërimin e gjuhës së huaj.
- l) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara mësipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, kati 3, Tiranë (tek Avokatura e Shtetit), Tiranë, brenda datës **05.11.2023**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

² Referuar kreut IV, pika 4, të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike.”

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **07/11/2023**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe standat e informimit me publikun të institucionit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- Njohuritë mbi Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr.97/2016 “Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimin të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimit, nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

2

NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se, është ende vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Këtë informacion do ta merrni në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit për publikun të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data 22/11/2023.

Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III-b; IV-a; IV-b (barazvlefshme me klasën IV-1/IV-2/IV/3³);
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike/ Shkenca Natyrore, Dega Matematik. *Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.*
- b) Të kenë jo më pak se 3 vjet përvojë pune në profesion.
- c) Preferohet të ketë të paktën 1 vit përvojë pune në fushën e statistikave.
- d) Të zotërojnë gjuhën angleze.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) Kërkesë për të konkuruar në pozicionin e shpallur në procedurën përkatëse;
- b) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- c) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;*
- d) Akti i konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore (vlefshmëria 3 muaj);
- h) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore në linkun: <https://ild.al/dokonline/Formular-vetdeklarimi-gjendje-gjyqesore.pdf>
- i) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt (për kandidatët në marrëdhënie pune 6 mujori i parë i vitit 2023);
- j) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- k) Dokument që vërteton zotërimin e gjuhës së huaj;
- l) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

³ Referuar kreut IV, pika 4, të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike.”

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentave të cituara mësipër, do të bëhet duke dorëzuar me postë ose fizikisht në mjediset e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Rruga “Abdi Toptani”, Nd. 5, kati 3, Tiranë (tek Avokatura e Shtetit), Tiranë, brenda datës **12.11.2023**.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **22/11/2023**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe standat e informimit me publikun të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, , për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në njësinë për menaxhimin e burimeve njerëzore, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- Njohuritë mbi Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Njohuritë mbi Ligjin nr.97/2016 “Për organizimin e funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë";
- Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimit për Ngritje në Detyrë brenda **3** ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stendën e informimit të publikut të institucionit. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit të publikut të institucionit, për fazat e mëtejshme:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit të publikut të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke filluar nga data: **22/11/2023**.*